



MESAZHI I KRISHTLINDJES I MINISTRAVE GJENERALË

Gjashtë Ministrat gjeneralë të Konferencës së Familjes Françeskane (Deborah Lockwood OSF, Presidente IFC-TOR; Tibor Kauser OFS, Michael Anthony Perry OFM, Roberto Genuin OFMCap, Carlos Alberto Trovarelli OFMConv e Amando Trujillo Cano TOR) kanë bashkëpunuar për të paraqitur Mesazhin e Krishtlindjes 2020: “Shpresa është e guximshme!”, drejtuar motrave dhe vëllezërve të të gjithë Familjes Françeskane. Po paraqesim një ekstrakt të tekstit:

Ndritshmëria dhe muzikaliteti janë dy prej shumë përbërësve të gramatikës së Krishtlindjes. Toma nga Çelano, duke i treguar Krishtlindjen Greços, flet për një natë që “është e qartë si ditë e plotë dhe e këndshme për njerëzit e për kafshët!”. Në këtë natë “njerëzit vrapojnë e gëzohen prej një hareje të pashijuar kurrë më parë, para misterit të përtërirë. Pylli jehon prej zërash dhe shkëmbinjtë jehojnë prej koresh në festë. Këndojnë fretërit lavdet që i kanë hije Zotit, dhe nata duket e gjitha një gulçim gëzimi” (krh. BF 469).

Si përfaqësues të Familjes së madhe Françeskane ndërkombëtare, ndërsa tejshohim tashmë Dritën që vjen prej Lart, ju propozojmë, në gjuhë muzikore, një reflektim mbi tingëllimin e bukur të Enciklikës *Vëllezër të gjithë*. [...]

Jemi duke përfunduar Ardhjen, dhe Krishtlindja tashmë është në horizont! Mungojnë pak ditë prej fundit të vitit 2020, por që tani mund të themi se ka qenë një vit shumë i veçantë. Duket se në këta muajt e fundit kemi jetuar përvojat që do të mjaftonin për një dhjetëvjeçar të tërë. Virusi, ndryshimet politike, protestat në shumë shtete, tensionet, luftërat, përbuzja, skartimi, kaosi i informacioneve – kemi përjetuar se bota është bërë më e errët dhe, me bashkëpunimin edhe të karantinimeve të ndryshme, më e mbyllur (krh. FRANÇESKU, *Vëllezër të gjithë* [=VGJ], kap. I: *Hijet e një bote të mbyllur*, nr. 9-55). Dhe pikërisht në këtë moment historik kemi marrë prej Papës Françesku Enciklikën *Vëllezër të gjithë*, në të cilën bashkëndan dëshirën që të kemi guximin për të ëndërruar, për të aspiruar një familje njerëzore të bashkuar, një përqafim global mes motrash e vëllezërish, “bij të së njëjtës tokë që na mirëpret të gjithëve ne” (VGJ nr. 8).

Lexo tekstin e plotë, në gjuhë të ndryshme, në OFM.org:

[ARA](#) - [DEU](#) - [ENG](#) - [FRA](#) - [HRV](#) - [HUN](#)
[IND](#) - [ITA](#) - [KOR](#) - [NLD](#) - [POL](#) - [POR](#)
[RUM](#) - [RUS](#) - [SPA](#) - [SWA](#) - [ZHS](#) - [ZHT](#)

LAJME TË TJERA



Mensa Françeskane: Kërkesat për ndihmë janë shtuar me 45%

Më 24 nëntor 2020, [Agjencia e Gazetarisë Itali \(AGI\)](#) ka botuar artikullin në lidhje me shtimin e numrit të personave që vizitojnë mensat françeskane:

Janë më shumë se 300 mijë vaktet e ngrohta të shërbyera që prej fillimit të emergjencës deri më sot, në 15 mensat françeskane të mbështetura nga projekti solidar i Antonianit “Operacioni Buka”, 45% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Fushatat e Antonianit mbështetin në të gjithë Italinë mensat françeskane që çdo ditë u shërbejnë mijëra vakte atyre që nuk kanë për të ngrënë.

Vëllezërit e mensave të “Operacionit Buka” vazhdojnë të punojnë në linjë të parë për të qëndruar edhe më afër atyre që kanë nevojë, me një vakt të ngrohtë, me një fjalë ngushëllimi, me një ndihmë në shpenzimet e përditshme dhe çka shërben për të kaluar natën.

Për më shumë informacione:
www.operazionepane.it

RIP: Imzot Marco Dino Brogi

Më 29 nëntor 2020 ka vdekur në Firenze bashkëvëllai ynë imzot Marco Dino Brogi, Arqipeshkëv titullar i Qytetit Dukal, Nunc Apostolik. 88 vjeç, 63 vjet jetë rregulltare, 35 vjet shërbesë presbiteriale, 22 vjet episkopat.

Ndër detyrat e ndryshme domethënëse, ka qenë Këshilltar i Këshillit Superior të Veprave Papnore



Misionare, mësues në Egjipt dhe në Romë, qe ndër anëtarët e parë të Société du Droit des Eglises Orientales e Asesor Científico i Revista Española de Derecho Canónico, autor i studimeve të ndryshme mbi të drejtën kanonike lindore.

U emërua në vitin 1997 nga shën Gjon Pali II Nunc Apostolik në Sudan dhe Delegat Apostolik në Somali, u shugurua ipeshkëv nga Papa Vojtila më 6 janar 1998; nga 2002 deri në 2006 shërbeu si Nunc Apostolik në Egjipt dhe Delegat i Selisë së Shenjtë pranë Lidhjes së Vendeve Arabe.

Lexo më shumë: ofm.org

RIP: Fra Luigi Perugini

Më 27 nëntor 2020, pranë spitalit të S. Benedetto del Tronto (AP-Itali), ka vdekur fra Luigi Perugini.

Ndër detyrat e shumta, ka qenë Ministër Provincial, President i Konferencës së Ministrave Provinciale të Italisë (COMPI), Definitor Gjeneral dhe President i Fondacionit Veprat Antoniane. Nga 1997 deri në 2003 qe Drejtor i Zyrës së komunikacionit të Kuries Gjenerale dhe, nga 1997 deri në 2015, Drejtor i Revistës Acta Ordinis. Në 2018, u kthye në Provincë për t’u kuruar dhe asistuar.

Në harkun e gati tridhjetë viteve, fra Luigi qe Definitor gjeneral dhe, pra, bashkëpunëtor me tituj të ndryshëm i plot katër Ministrave gjeneralë.

Ministri Gjeneral aktual, në letrën e tij të lajmërimit të Provincës, ka theksuar “kompetencë, seriozitet, besnikëri dhe bujari e madhe në çdo lloj pune e roli që i është kërkuar”.

Lexo më shumë: ofm.org



Takim mbi protomartirët françeskanë

Më 6 dhjetor 2020 u zhvillua në streaming takimi mbi protomartirët françeskanë në Marok – interpretime në ballafaqim me rastin e tetëqindvjetorit të vdekjes së pesë fetërve françeskanë të vrarë në Marok në vitin 1220.

Takimi shqyrtoi marrëdhënien mes protomartirëve françeskanë dhe shën Antonit të Padovës, misionet e para françeskane, ikonografinë e protomartirëve, marrëdhënien mes françeskanizmit dhe islamit.

Protomartirët françeskanë janë një faqe e rëndësishme e historisë françeskane: shenjtëria e tyre tërhoqi mes fetërve minorë shën Antonin e Padovës, u admirua nga shenjtja Klara, u bë shembull për të lumin Egjid të Asizit. E pra ngjarja e predikimit të tyre në Marok, që përfundoi me martirizimin, shtron pyetje të ndryshme. Prandaj, me rastin e tetëqindvjetorit të vdekjes së tyre (1220-2020), dëshirohet të kuptohet më mirë se çfarë ndodhi dhe domethënia që martirizimi i tyre merr sot për të krishterët e myslimanët.

Për më shumë informacione:
www.istess.it

I nderueshmi Shërbëtori i Hyjit Antonio Seghezzi, meshtar dioqezan

Më 21 dhjetor 2020, Ati i Shenjtë Françesku autorizoi shpalljen e Dekretit në lidhje me virtytet heroike të Shërbëtorit të Hyjit Antonio Seghezzi, meshtar dioqezan, i lindur në Premolo, Dioqeza e Bergamos, më 25 gusht 1906, dhe i vdekur në kampin e përqendrimit të Dakaut më 21 maj 1945.

Çështja e lumnimit, e nisur në vitin 1990, i qe besuar postulitorit gjeneral OFM.

Lexo më shumë: ofm.org

BOTIME TË REJA FRANÇESKANE

**FRANCESCO D'ASSISI
E AL-MALIK AL-KAMIL**

L'icona del dialogo
tra storia e attualità



**SARA MUZZI E GIUSEPPE
BUFFON OFM (nën kujdesin e),
Francesco d'Assisi e al-Malik al-
Kamil: L'icona del dialogo tra
storia e attualità (Françesku i
Asizit dhe al-Malik al-Kamil: Ikona
e dialogut mes historisë dhe
aktualitetit), Botimet Terra Santa-
PUA, Milano 2020, fq. 264**

Në tetëqindvjetorin e takimit mes Françeskut dhe Sulltanit, Universiteti Papnor Antonianum i Romës e ka përkujtuar këtë ngjarje me një seri kuvendesh, me qëllim që të shqyrtohet natyra, historia dhe domethënia e këtij takimi.


Relacionet e mbajtura në këto raste janë përmbledhur në këtë vëllim. Ndhimesat nuk kufizohen vetëm duke vënë në dukje shumësinë e perspektivave dhe gjykimeve në lidhje me këtë ngjarje, por edhe më shumë, në studimin e kujdesshëm të këtyre tetë shekujve histori, hetojnë, me një kujdes historiko-kritik, elementet përbërëse që i dhanë fillësë dhe me mprehtësi hermeneutike vërejnë potencialitetet në mënyrë që, “e përditësuar”, të mund të paraqitet gati si një model në gjendje që të orientojë dhe cilësojë qëndrimet që favorizojnë dialogun dhe të mirën e përbashkët të shoqërisë sonë. Nga sa ka dalë në pah në takimet përkujtuese, të botuara tani në këtë vepër, mund të sinjalizohen tri pika që aktualizojnë dinamikën e takimit mes Françeskut dhe Sulltanit: hapësira që Burimet Françeskane i kushtojnë kësaj ngjarjeje, domethënia që ajo ka për kohën tonë dhe ndihmesa frymëzuese që jep në magjisterin e papës Françesku.

**SAN FRANCESCO
e i Suoi frati**
In missione nella terra del Sultano




**SARA COLASANTI E CATERINA
AGRÒ, San Francesco e i suoi frati
in missione nella terra del sultano
(Shën Françesku dhe frerët e tij
në mision në tokën e sulltanit),
Botimet Biblioteca Francescana,
Milano 2020, fq. 28**

Protomartirët françeskanë qenë të parët që, me ftesën e vetë shën Françeskut, shkuan përtej kufinjve të Europës, u shpallën të largëtve Ungjillin e Jezusit me guxim e vendosmëri, duke sfiduar mbretër e sulltanë të fuqishëm deri në fljimin e jetës së tyre. Një udhëtim i jashtëzakonshëm nga Asizi deri në Marrakesh nëpërmjet popujsh e kulturash.



**ALBERT HAASE OFM, Soul
Training with the Peace Prayer
of Saint Francis (Ushtrime të
shpirtit me Lutjen e Thjeshtë të
shën Françeskut), Franciscan
Media, Cincinnati 2020, fq. 192**

Lutja e Thjeshtë, e atribuar Françeskut të Asizit në fillimet e shek. XX, ka bashkëdepërtuar ndërgjegjen fetare të çdo besimtari duke u bërë një prej lutjeve më të njohura dhe të dashura të të gjitha kohëve. Duke përdorur histori të marra prej jetës si të Shën Françeskut ashtu edhe të njerëzve të zakonshëm, Albert Haase OFM tregon se si Lutja e Thjeshtë i jep formë shpirtit duke na nxitur të jetojmë një jetë shërbimi (strofa e parë) dhe altruizmi (strofa e dytë). “Duke përdorur Lutjen e Thjeshtë të Shën Françeskut, Albert Haase OFM edhe një herë tregon se, nëse do ta bëjmë tonën këtë lutje, të gjithë ne do të ndërmarrim një udhëtim të gjatë përfundimi i të cilit do të jetë realizimi i ëndrrave tona më të thella”. (Në Shtojcë përvijohet historia se si lutja iu atribua Shenjtit të Asizit).



Martín Carbaño Núñez

SER FRANCISCANO EN LA ERA DIGITAL
Los retos de la comunicación
y de la ecología integral

**MARTÍN CARBAJO NÚÑEZ
OFM, Ser franciscano en la era
digital. Los retos de la
comunicación y de la ecología
integral (Të jesh françeskan në
epokën dixhitale. Sfidat e
komunikimit dhe të ekologjisë
integrale), Ediciones
Franciscanas Arantzazu, Oñati
2020, fq. 302**

Martín Carbaño Núñez na paraqet në këtë libër aktualitetin e karizmës dhe të traditës françeskane për të përballuar sfidat socio-mjedisore dhe të komunikimit të shoqërisë së globalizuar. Perspektiva françeskane i përshtatet mirë llojit të komunikimit horizontal, intuitiv dhe ndërveprues që mbizotëron në epokën dixhitale. Në dritën e Shpirtit duhet të shohet bërthama e përvojës së Françeskut për ta rimishëruar atë sot në mënyrë krijuese dhe të përshtatshme, duke zhvilluar aftësinë për të dëgjuar, soditur, shoshitur, dialoguar dhe mbarështuar të mirat në logjikën e dhurimit.

DORACAKË TË RINJ



SGME: MBRETËRIA E HYJIT ËSHTË AFËR. ORIENTIME PËR UNGJILLËZIMIN MISIONAR FRANÇESKAN

Nga Sekretaria e Përgjithshme për Misionet dhe Ungjillëzimin: një dokument si "orientime" për të jetuarit dhe të shpallurit tonë të Ungjillit në botën e sotme... për të animuar të gjithë vëllezërit që të lexojnë shenjat e kohëve, që të rilexojnë Ungjillin, të rizbulojnë formën e të jetuarit të karizmës sonë sot dhe të aktualizojnë si vëllazëri soditëse në mision ungjillëzues aty ku gjenden me guximin e të qenurit protagonistë dhe të të bërit ndryshimin me një ungjillëzim të përditësuar e efikas.

DOWNLOAD:

[English](#) - [Español](#) - [Italiano](#) - [Português](#)

FRANCISCANS INTERNATIONAL: SHEMBJA E MUREVE

Franciscans International paraqet dokumentin që synon të përgënjeshtrojë mitet kryesore në lidhje me migrimet dhe lëvizshmërinë njerëzore më në përgjithësi nga këndvështrimi i të drejtave njerëzore duke përshkruar, me këtë qëllim, përvojat e jetës të përjetuara nga françeskanët dhe referentë të tjerë. Urojmë që botimi të mund t'i ndihmojë françeskanët, grupet e tjera rregulltare dhe organizatat lokale të shoqërisë civile që të përballojnë e kundërshtojnë, së bashku me publikun më të gjerë dhe me autoritetet lokale, bestytnitë e rreme, qëndrimet ksenofobe, raciste e politike të abuzimit në dëm të lëvizshmërisë njerëzore.

DOWNLOAD:

[English](#) - [Español](#) - [Italiano](#) - [Português](#) - [Deutsch](#)



MINISTRA TË RINJ PROVINCIALE

Fra Sanguk Joseph Kim
Provinca e Shenjtërve Martirë të Koresë
Kore

Fra Ángel Gabino Gutiérrez Martínez
Provinca e Shën Françeskut e Jakobit
Meksikë

Fra Joel Cosme Torres
Provinca e Ungjillit të Shenjtë
Meksikë

KUSTOD I RI

Fra Pashko Gojçaj
Kustodia e Zojës Nunciatë
Shqipëri dhe Mal i Zi

AXHENDA E MINISTRIT GJENERAL

JANAR

6

ROMË

E kremtja e Dëftimit në Aracoeli

18

ROMË

Festa e Universitetit Antonianum

20

ROMË

Zoom Meeting USG
mbi temën e Instituteve të Përziera

18-27

ROMË

Kohë e Fortë

28

SHBA

Pushime dhe Kontrolle mjekësore